AUTORITETI KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK

# TREGUESIT STATISTIKORE TE TREGUT TE KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE

## 6 MUJORI I-rë 2013

## TELEFONI CELULARE

## TELEFONI FIKSE

## INTERNET

Nentor 2013

**I.HYRJE** ..................................................................................................................3
**II. PANORAME E PERGJITHSHME**....................................................................................4
**III. TELEFONIA CELULARE** ........................................................................................7
III.1 Struktura e perdoruesve dhe pjeset e tregut te operatoreve celulare ....................................... 7
III.2. Trafiku telefonik.......................................................................................................... 13
**Sherbime UMTS ( 3G)**.................................................................................................... 15
**IV. TELEFONIA FIKSE** .................................................................................................17
IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut ............................................................................. 17
**V. INTERNETI**
V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre..................20
V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura ................................................ 21

**Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2013/1**.............................. 6
**Figura 3. Krahasimi i normave te penetrimit: Shqiperi 2013/1 vs mesatare e BE- 27**... **Error! Bookmark not defined.**
**Figura 4. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë aktive 2010-2013/1**...................................... 8
**Figura 5. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë "aktive" dhe SIM 2010-2013/1** ................. 8
**Tabela 1: Numri i detajuar i perdoruesve celulare 2013/1 (zerat kryesore)**.......................... 10
**Figura 6: Pjeset e tregut te operatoreve celulare grafikisht per 2013/1** .................................. 12
**Tabela 4: Sherbime roaming nderkombetar 2010 – 2013/1**................................................... 15
**Tabela 5: Tregues te ofrimit te sherbimeve 3G (2011- 2013/1)**.............................................. 16
**Tabela 6: Ecuria e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2010-2013/1)** ......................................................................................................................... 18
**Figura 8: Pjeset e tregut te numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2013/1)** ..................... 18
**Tabela 7: Shperndarja e numrit te pajtimtareve me akses broadband (2010-2012)**............ 19
**Figura 9: Pjeset e tregut per akses broadband (2013/1)**......................................................... 20
**Tabela 8. Te dhena per infrastrukturen e aksesit në Internet në nivel me shumicë 2013/1** 21

## I.HYRJE

AKEP, me qellim informimin e publikut, paleve te interesuara dhe te sipermarresve te tregut te komunikimeve elektronike me treguesit kryesore te ketij tregu, ne vijimesi te raporteve periodike te publikuar ne faqen e Internetit te AKEP www.akep.al ne seksionin Statistika, ka pergatitur kete raport ne te cilin publikohen treguesit kryesore te tregut per 6 mujorin e I-re te vitit 2013 si dhe ndryshimet me periudhat e meparshme.

Ky raport eshte pergatitur duke iu referuar te dhenave te derguara nga operatoret celulare, Albtelecom si dhe te dhenave te Operatoreve Alternative dhe Ofruesve te sherbimeve, sipas formulareve te Rregullores te te dhenave statistikore, te plotesuar nga sipermarresit e autorizuar nga AKEP. Per shkak te ruajtjes se konfidencialitetit te te dhenave, jo te gjithe treguesit e raportuar nga operatoret publikohen nga AKEP.

Raporti ka natyre periodike dhe mund te pasurohet edhe me tregues te tjere apo informacion me te plote per operatoret alternative.

## II. PANORAME E PERGJITHSHME

Në fund të 6 mujorit te I-re te vitit 2013, numri i perdoruesve të telefonisë së lëvizshme (karta SIM aktive) eshte rreth 4.86 milion krahasuar me 5.6 milion sipas te dhenave ne fund te vitit 2012. Kjo perben nje renie te theksuar prej rreth 13% krahasuar me fund vitin 2012. Arsyeja e renies se theksuar te ketij treguesi vjen per shkak te ndryshimit te menyres se matjes te ketij treguesi nga Eagle Mobile[1]

Nderkohe numri i perdoruesve aktive (perdorues te kartave SIM qe kane perdorur sherbime celulare ne 3 muajt e fundit) ne fund te 6 mujorit te I-re te vitit 2013 arriti ne 3.37 milion, kundrejt 3.5 milion qe ishin ne fund te vitit 2012. Kjo perben nje renie rreth 5% ne krahasim me te dhenat e fund vitit 2012.

Keshtu qe referuar te dhenave te 6 mujorit te I-re 2013, numri i përdoruesve për 100 banorë ne fund te 2012 ishte 172% kundrejt 198 % qe ishte ne fund te vitit 2012 (per karta SIM aktive) ndersa sipas numrit te perdoruesve aktive ne fund te 6 mujorit te I-re 2013 eshte 119 % , kundrejt 125 % qe ishte ne fund te vitit 2012.

AKEP gjykon se ndryshimi në vlerat e cituara më sipër (karta SIM dhe perdroures aktive) ndodh për shkak se në shifrën numrit të kartave SIM te permendura më sipër ka një numër të konsiderueshëm pajtimtarësh me përdorim sezonal, si p.sh emigrantë apo vizitorët në Shqipëri (emigrantet/turistet ne periudhen e veres nuk perfshihen ne perdorues aktive), si edhe një numër pajtimtarësh që mund të mos e përdorin më një kartë SIM, megjithëse ajo rezulton aktive. Praktikat e raportimit ndryshojne ne vende te ndryshme, por kohet e fundit ka nje rritje te raportimit te numrit te perdoruesve celulare aktive. Në referenca të tjera në këtë raport, AKEP i referohet kryesisht numrit të perdoruesve celulare sipas numrit te 'perdoruesve aktive', por nderkohe ne disa raste jepen edhe tregues bazuar ne numrin e perdoruesve celulare sipas kartave SIM aktive. Ky perben ndryshim nga raportet e meparshme dhe lexuesi duhet te kete parasysh kete ndryshim. Te dhenat per numrin e perdoruesve celulare sipas kartave SIM aktive jane te disponueshme qe prej vitit 1996 ndersa sipas treguesit 'perdorues aktive' qe prej vitit 2010.

Ne vleresimin e pajtimtareve te telefonise fikse per 6 mujorin e I-re 2013, eshte reflektuar nje renie e theksuar e numrit te pajtimtareve te cilet ishin raportuar ne fund te vitit 2012. Pas sqarimeve te bera me operatoret perkates, sjellin ne vemendje se ne raportimet e tyre jane konsideruar vetem pajtimtaret aktive (pagues), ndersa numri i pajtimtareve ne totalin e tyre rezulton te jete pothuajse i njejte me raportimet e fund vitit 2012.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund 6 mujorit te I-re 2013 eshte rreth 280 mije, kundrejt rreth 311 mijë qe ishin ne fund te vitit 2012, nivel i cili përbën një renie me rreth 10 %. Kryesisht kjo renie ka ardhur per shkak te reduktimit te numrit te pajtimtareve te Albtelecom me rreth 11mije krahasuar me te dhenat e fund vitit 2012 si dhe ndryshimit te

[1] EM deri ne fund 2012 ka raportuar nder vite vleren kumulative te kartave SIM te shitura qe prej fillimit te aktivitetit te tij deri ne fund te periudesh perkatese, ndersa per gjashtemujorin e pare 2012 EM ka rivleresuar numrin e pajtimtareve duke ju permbajtur vetem kriterit te kartave SIM aktiv brenda nje viti.

madh te sjelle ne te dhenat e operatorit alternativ Abcom, pasi referon te dhena me nje renie rreth 20 mije pajtimtare (sipas percaktimit te bere vetem si pajtimtare aktive). Sqarojme qe ne te dhenat e fund vitit 2012 Abcom ka raportuar 33 mije pajtimtare, ndersa ne fund te 6 mujorit te i-re 2013, referon vetem 13 mije pajtimtare.

Duke vleresuar te dhenat e derguara nga operatoret e telefonise fikse, rezulton qe norma e penetrimit te telefonise fikse ne Shqiperi  eshte rreth 10 %, kundrejt  penetrimit prej 11% qe ishte ne fund te vitit 2012 dhe ne nje  nivel qe është shumë i ulët krahasuar me vendet e BE ( me një mesatare prej 40%) dhe vendet e rajonit.

Figura e mëposhtëme paraqet ecurinë ndër vite të numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse dhe celulare.

**Figura 1. Ecuria e numrit te perdoruesve të telefonisë celulare dhe fikse 2000-2013/1**




| | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013/1 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Fiks | 152,70 | 197,50 | 222,00 | 243,85 | 256,26 | 273,05 | 289,63 | 296,14 | 303,96 | 337,88 | 331,50 | 338,84 | 325,00 | 279,43 |
| Celulare | 28,775 | 351,90 | 786,14 | 1,099, | 1,259, | 1,530, | 1,909, | 2,322, | 2,964, | 4,184, | 4,547, | 5,236, | 5,619, | 4,861, |

Figura e mëposhtme paraqet ecurine e penetrimit (numri i perdoruesve per 100 banore[2]) të telefonisë celulare dhe fikse per periudhen 2003-2013/1.

**Figura 2. Ecuria e penetrimit të telefonisë celulare dhe fikse 2003-2013/1**




| | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013/1 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Fiks | 7.81% | 8.16% | 8.65% | 9.12% | 9.27% | 10.09% | 10.50% | 10.20% | 12.00% | 11.00% | 10.00% |
| Celulare | 35.22% | 40.09% | 48.45% | 60.12% | 72.70% | 92.29% | 129% | 140% | 185% | 198% | 172% |

Sipas të dhënave te 6 mujorit te I-re 2013, nga Albtelecom, Operatoret alternative si dhe te dhenave nga tre rrjetet 3G, konkretisht te Vodafone, AMC dhe Albtelecom Mobile (Eagle), per numrin e pajtimtareve me akses ne broadband nepermjet rrjetit 3G si dhe vlerësimeve të AKEP, rezulton qe numri i familjeve që kanë akses në Internet me bandë të gjerë (broadband) është rreth 195 mije apo afërsisht 27 % e familjeve, ndërsa vlerësohen të jenë rreth 15.000 pajtimtarë biznesi.

Numri total i pajtimatreve me akses braodabnd (fix dhe karta/USB modem 3G) pati renie nga 215 mije ne fund te 2012 ne rreth 210 mije ne fund te 6 mujorit te I-re 2013. Numri i pajtimatreve per 100 banore arriti ne 7.4%, nga rreth 7.6 qe ishte në fund të vitit 2012. Renia ka ndodhur per shkak te renies se numrit te pajtimatrve me akses broadband 3G (Vodafone) ndersa numri i pajtimtarev me akses broadband fiks pati rritje me 5%.

[2] Numri i banoreve ne Shqiperi i referohet te dhenave te Instat per numrin e popullsise (sipas Census 2011)

# III. TELEFONIA CELULARE

## III.1 Struktura e perdoruesve dhe pjeset e tregut te operatoreve celulare

Në fund të 6 mujorit te I-re te vitit 2013, numri i perdoruesve të telefonisë së lëvizshme (karta SIM aktive) eshte rreth 4.86 milion krahasuar me 5.6 milion sipas te dhenave ne fund te vitit 2012. Kjo perben nje renie te theksuar prej rreth 13% krahasuar me fund vitin 2012. AMC dhe Vodafone kane rritje me 3-4% dhe Plus ka rritje me 9%, ndersa Eagle Mobile ka renie me 64% qe perben edhe arsyen e renies se theksuar te ketij treguesi. Reduktimi i madh e ketij tregues per EM vjen per shkak te ndryshimit te menyres se matjes te ketij treguesi nga Eagle Mobile[3].

Nderkohe numri i perdoruesve aktive (perdorues te kartave SIM qe kane perdorur sherbime celulare ne 3 muajt e fundit) ne fund te 6 mujorit te I-re te vitit 2013 arriti ne 3.37 milion, kundrejt 3.5 milion qe ishin ne fund te vitit 2012. Kjo perben nje renie rreth 5% ne krahasim me te dhenat e fund vitit 2012. Vodafone dhe Plus ka rritje me 4 dhe 11% respektivisht, ndersa AMC dhe EM kane reduktim me 12 dhe 18% respektivisht.

Sic eshte cituar edhe ne pjesen hyrese, në referenca të tjera në këtë raport, AKEP i referohet kryesisht numrit të perdoruesve celulare sipas ‘perdorures aktive’, por nderkohe ne disa raste jepen edhe tregues bazuar ne numrin e perdoruesve celulare sipas kartave SIM aktive. Te dhenat per numrin e perdoruesve celulare sipas kartave SIM aktive jane te disponueshme qe prej vitit 1996 ndersa sipas treguesit ‘perdorues aktive’ qe prej vitit 2010.

Figura 4, paraqet ecurine e numrit te perdoruesve celulare aktive ne periudhen 2010-2013/1, ndersa figura 5, paraqet numrit e pajtimatreve celulare sipas dy treguesve: ‘perdorues aktive’ dhe ‘karta SIM aktive’. Proporcioni i perdoruesve aktive ndaj kartave SIM aktive eshte ne nivel 69% per te kater operatoret se bashku, duke variuar nga 64% per AMC ne 74% per Vodafone. Ndryshimin me te madh te ketij raporti e ka EM, nga 31% ne fund te 2012 ne 70% ne fund te gjashtemujorit te pare 2013 (shiko shenimin per arsyen e ketij ndryshimi te madh). Pjeset e tregut te operatoreve sipas dy treguesve jane te perafert, dhe Vodafone Albania zoteron 46% per perdorues aktive dhe 43% per karta SIM. AMC zoteron 37% per perdoures aktive dhe 40% per karta SIM, ndersa EM dhe Plus kane respektivisht 10% dhe 7% pjese tregu per te dy treguesit.

[3] EM deri ne fund 2012 ka raportuar nder vite vleren kumulative te kartave SIM te shitura qe prej fillimit te aktivitetit te tij deri ne fund te periudesh perkatese, ndersa per gjashtemujorin e pare 2012 EM ka rivleresuar numrin e pajtimtareve duke ju permbajtur vetem kriterit te kartave SIM aktiv brenda nje viti.

**Figura 4. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë aktive 2010-2013/1**




| | 2010 | 2011 | 2012 | 2013/1 |
|---|---|---|---|---|
| AMC | 1,396,752 | 1,151,518 | 1,407,811 | 1,240,704 |
| Vodafone | 1,129,715 | 1,358,871 | 1,491,126 | 1,550,198 |
| EM | 602,775 | 415,307 | 435,922 | 356,059 |
| Plus | 28,162 | 182,391 | 202,426 | 224,819 |

**Figura 5. Ecuria e numrit të përdoruesve celularë "aktive" dhe SIM 2010-2013/1**




| | 2010 | | 2011 | | 2012 | | 2013/1 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | SIM | Aktive | SIM | Aktive | SIM | Aktive | SIM | Aktive |
| Plus | 28,162 | 28,162 | 396,722 | 182,391 | 302,310 | 202,426 | 329,496 | 224,819 |
| EM | 822,356 | 602,775 | 1,110,363 | 415,307 | 1,423,421 | 435,922 | 509,044 | 356,059 |
| Vodafone | 1,674,748 | 1,129,715 | 1,809,264 | 1,358,871 | 2,019,655 | 1,491,126 | 2,094,910 | 1,550,198 |
| AMC | 2,022,541 | 1,396,752 | 1,920,000 | 1,151,518 | 1,874,221 | 1,407,811 | 1,928,483 | 1,240,704 |

## Struktura e perdoruesve

Perdoruesit me kontrate perbejne 14% te numrit te perdoruesve aktive, ku Plus dhe Eagle Mobile kane vlerat me te larta me 48% dhe 28% respektivisht, ndersa Vodafone ka vleren me te ulet me 7%.
Perdoruesit me kontrate vazhdojne te zene rreth 10% te numrit total te perdoruesve te matur me karta SIM. Vleren me te madhe te ketij treguesi e ka Plus me 33%, ndersa me te ultin Vodafone me 5%.
Tabela e meposhteme paraqet strukturen e perdoruesve te kater operatoreve celulare per perqindjen e perdoruesve me parapagim dhe me kontrate te matur ne raport me numrin total te perdoruesve aktive dhe kartave SIM aktive.

**Tabela 3. Struktura e perdoruesve celulare 2013/1 ( shprehur ne %)**

| | AMC | Vodafone | Eagle Mobile | Plus | Total |
|---|---|---|---|---|---|
| Raporti Parapagim Aktiv/Total Aktiv | 86% | 93% | 72% | 52% | 86% |
| Raporti perdorues me parapagim/SIM Total | 91% | 95% | 81% | 67% | 90% |
| Raporti perdorues me Kontrate/ Total Aktiv | 14% | 7% | 28% | 48% | 14% |
| Raporti perdorues me Kontrate/SIM Total | 9% | 5% | 19% | 33% | 10% |

Tabela e meposhtme paraqet te dhena per 6 mujorin e I-re 2013, mbi numrin e pajtimtareve celulare te detajuar ne abonente Familjare dhe Biznes si dhe perdoruesit e sherbimeve te aksesit ne Internet dhe pajtimtaret qe kane nderruar program tarifor brenda te njejtit operator, si dhe tregues te numrit te pajtimtareve qe kane perdorur sherbimin e portabilitetit te numrit ne rastin e largimit nga rrjeti juaj si dhe te ardhjes ne rrjetin tuaj sipas tabeles se meposhtme.

Tabela 1: Numri i detajuar i perdoruesve celulare 2013/1 (zerat kryesore)

| Detajime per pajtimtaret e telefonise celulare | AMC | VF-AL | EAGLE | PLUS |
|---|---|---|---|---|
| **Numri pajtimtareve te telefonise celulare ne total i detajuar:** | 1,928,483 | 2,094,910 | 509,044 | 329,496 |
| Perdorues familjare | 1,788,649 | 1,998,664 | 401,364 | 224,662 |
| Perdorues biznes | 139,834 | 96,246 | 107,680 | 104,834 |
| **Numri i pajtimtareve qe perdorin rrjetin celular per akses ne internet me GPRS/EDGE** | 1,332,100 | 430,100 | 158,783 | 96,941 |
| **Numri pajtimtareve te telefonise mobile me akses ne Internet broadband UMTS(3G) ne total:** | 240,431 | 241,445 | 59,958 | |
| - nepermjet aparatit te telefonit celular | 222,460 | 220,396 | 57,076 | |
| - nepermjet cards/modems/keys (jo aparate celulare) | 17,971 | 21,049 | 2,882 | |
| **Numri i Pajtimtareve qe kane nderruar program tarifor** | 11,773 | 33,057 | 3,457 | 4,549 |
| **Numri i pajtimtareve qe kane nderruar operator (portabilitet numri)** | 26,289 | 112 | 27,623 | 23,713 |

**Pjeset e tregut celulare per disa tregues kryesore**

Pjesët e tregut të operatorëve celularë jane vleresuar ne disa prej treguesve kryesore sipas te dhenave te depozituara ne AKEP, te cilat jane te paraqitura sipas tabelave dhe grafikeve te meposhtem dhe qe permbajne pjese tregu per:
Perdorues Aktive; Perdorues (Karta SIM); Perdorues me Kontrate; Thirrje dalese; SMS dhe Te ardhura (te ardhurat per vitin 2012).

Nga vleresimi i pjeseve te tregut per 6 mujorin e I-re 2013 per zerat: Perdorues Aktive; Perdorues (Karta SIM); Perdorues me Kontrate; Thirrje dalese dhe SMS ne total, rezulton qe ka nje renie pjeseve te tregut per AMC dhe Eagle Mobile ne numrin e perdoruesve aktive ne rreth 3 % dhe 2 % perkatesisht si dhe nje rritje te numrit te perdoruesve aktive per Vodafone Albania dhe Plus Communications perkatesisht ne vlerat 4 % dhe 1%. Krahasimi eshte bere per 2013/1 dhe fund vitin 2012.

Ndersa ne lidhje me treguesit per thirrjet dalese situata paraqitet pothuajse e njejte krahasuar me fund vitin 2012, duke reflektuar nje renie te vogel per Eagle Mobile si dhe nje rritje jo te konsiderueshme per Plus Communication ( vlera e ndryshuar eshte ne 1%, per secilin nga ndryshimet e cituara).

Vlen te theksohet qe ne vleresimin e pjeseve te tregut per thirrjet dalese jane te perfshira edhe thirrjet on-net.

Ne lidhje me pjeset e tregut per SMS dalese, rezulton qe nuk ka asnje ndryshim nga te dhenat e vitit 2012, pjeset e tregut per sejcilin nga operatoret jane te pandryshuara gjate kesaj periudhe.

**Tabela 2: Pjeset e tregut celulare per disa tregues kryesore 2010-2013/1**

| | | AMC | VODAFONE ALBANIA | EAGLE MOBILE | PLUS COMMUNICATION |
|---|---|---|---|---|---|
| Perdorues Aktive | **2013/1** | **37%** | **46%** | **10%** | **7%** |
| | **2012** | **40%** | **42%** | **12%** | **6%** |
| | 2011 | 37% | 44% | 13% | 6% |
| | 2010 | 44% | 36% | 19% | 1% |
| | | | | | |
| Perdorues (Karta SIM) | **2013/1** | **40%** | **43%** | **10%** | **7%** |
| | **2012** | **33%** | **36%** | **25%** | **6%** |
| | 2011 | 37% | 35% | 21% | 8% |
| | 2010 | 44% | 37% | 18% | 1% |
| | | | | | |
| Perdorues me Kontrate | **2013/1** | **36%** | **21%** | **21%** | **22%** |
| | **2012** | **31%** | **18%** | **36%** | **15%** |
| | 2011 | 35% | 24% | 34% | 7% |
| | 2010 | 43% | 30% | 27% | - |
| | | | | | |
| Thirrje dalese | **2013/1** | **39%** | **50%** | **7%** | **4%** |
| | **2012** | **39%** | **50%** | **8%** | **3%** |
| | 2011 | 37% | 51% | 10% | 2% |
| | 2010 | 46% | 45% | 9% | - |
| | | | | | |
| SMS | **2013/1** | **20%** | **73%** | **6%** | **1%** |
| | **2012** | **20%** | **73%** | **6%** | **1%** |
| | 2011[4] | 27% | 64% | 8% | 1% |
| | 2010 | 34% | 57% | 9% | - |
| | | | | | |
| Te ardhura | **2012** | **29%** | **56%** | **10%** | **5%** |
| | **2011** | **34%** | **52%** | **12%** | **2%** |
| | 2010 | 40% | 48% | 12% | - |

[4] Pjeset e tregut per SMS per vitin 2011 te publikuara me pare jane korrigjuar. Lexuesi lutet t'i referohet ketyre vlerave te rishikuara per SMS per vitin 2011.

Figura 6: Pjeset e tregut te operatoreve celulare grafikisht per 2013/1



### III.2. Trafiku telefonik

Trafiku telefonik dales ne total ne fund te 6 mujorit te I-re 2013, krahasuar me fundin e 6 mujorit te I-re 2012 ka nje rritje ne rreth 16 %. Ky tregues eshte pozitiv dhe tregon per rritjen e perdorimit te sherbimit te thirrjeve telefonike dalese.

Duke krahasuar trafikun e zhvilluar per 6 mujorin e I-re 2013 me trafikun e zhvilluar per 6 mujorin e I-re 2012, per zerat: thirrje dalese brenda rrjetit; thirrje dalese drejt rrjeteve te tjera celulare; thirrje dalese; thirrje dalese drejt rrjeteve fikse si dhe thirrje dalese nderkombetare ka nje rritje respektivisht ne vlerat: rreth 16%, 20 %, 9 %, dhe 48 %, vlera keto te krahasuara me te dhenat e 6 mujorit te I-re 2012.

Duke krahasuar volumin e trafikut per terminimin e thirrjeve ne totalin e thirrjeve te terminuara per 6 mujorin e I-re 2013 me trafikun e terminuar per 6 mujorin e I-re 2012, rezulton te kete nje renie prej rreth 2% (ne totalin e trafikut te terminuar).

Ndersa trafiku i terminuar ne rrjetet celulare dhe origjinuar ne rrjetet e tjera celulare rezulton te kete nje rritje rreth 21%. Kurse per thirrjet e terminuara ne rrjetet celulare qe kane per origjine rrjetet fikse kombetare rezultojne te kete nje renie prej rreth 20%, ndersa trafiku i terminuar ne rrjetet celulare me origjine nderkombetare rrezulton te kete nje renie prej rreth 12%. Krahasimi eshte bere ndermjet trafikut te 6 mujorit te I-re 2013 dhe trafikut te terminuar ne rrjetet celulare per 6 mujorin e I-re 2012.

Terminimi i SMS-ve ne 6 mujrin e I-re 2013, ka nje rritje prej rreth 5 % krahasuar me 6 mujorin e pare 2012

Ne lidhje me perdorimin nga pajtimtaret e rrjeteve celulare (rrjetet shqiptare) te sherbimit te Roamingut Nderkombetar (thirrje te gjeneruara), per trafikun e zhvilluar duke perdorur kete sherbim duke krahasuar 6 mujorin e I-re 2013 me 6 mujorin e I-re 2012, rezulton te kete nje rritje prej rreth 22%. Ndersa ne lidhje me trafikun e zhvilluar per thirrje te marra (hyrese) nga pajtimtaret e rrjeteve celulare gjate kohes me roaming nderkombetar, rezulton te kete nje renie prej rreth 4%.

Ndersa ne lidhje me trafikun e zhvilluar per thirrje te gjeneruara nga pajtimtaret e rrjeteve te huaj gjate roamingut nderkombetar ne rrjetet celulare kombetare shqiptare, per te njejten periudhe kohore te krahasuar per 6 mujorin e I-re 2013 me 6 mujorin e I-re 2012, rezulton te kete nje rritje prej rreth 23%. Ndersa ne lidhje me trafikun e zhvillura per thirrjet te marra (hyrese) nga pajtimtaret e rrjeteve te huaj gjate roamingut nderkombetar ne rrjetet celulare shqiptare per te njejten periudhe kohore te krahasuar per 6 mujorin e I-re 2013 me 6 mujorin e I-re 2012, rezulton te kete nje renie prej rreth 22%.

Nga krahasimi i SMS te gjeneruara dhe marra nga pajtimtaret e rrjeteve te huaj gjate roamingut nderkombetar ne rrjetet celulare shqiptare, per te njejten periudhe kohore te krahasuar per 6 mujorin e I-re 2013 me 6 mujorin e I-re 2012, rezulton te kete nje rritje prej rreth 38%.

### III.3. Perdorimi mesatar mujor i sherbimeve celulare 2011-2013/1

Ne vijim eshte dhene nje tabele me te dhena per perdorimin mujor per perdorues celulare ne 2011 deri ne 2013/1. Perdorimi mesatar mujor per perdorues eshte llogaritur sipas thirrjeve dalese (thirrje qe gjenerohen nga nje perdorues) dhe thirrjeve hyrese (thirrjet e marra nga nje perdorues), te matura ne minuta. Keta tregues jane llogaritur per te gjithe trafikun e gjeneruar dhe marre gjate periudhes pjestuar me numrin mesatar te perdoruesve gjate periudhes (mesatarja e numrit te perdoruesve ne fillim dhe ne fund te periudhes). Thirrjet dalese perfshijne gjithe trafikun e origjinuar nga perdoruesit celulare ndersa thirrjet hyrese perfshijne thirrjet e marra nga perdoruesit, nga rrjete te tjera dhe nga i njejti rrjet. Perdorimi mujor i SMS i referohet vetem mesazheve te derguar. Keto te dhena paraqiten ne tabelen e meposhtem per perdorimin mesatar te nje perdoruesi celular, i perllogaritur me te dhenat e tre operatoreve celulare.

Gjithashtu treguesit jane llogaritur per numrin e perdoruesve celulare sipas kartave SIM (totali i pajtimtareve) si dhe perdorues aktive.

**Tabela 3: Përdorimi mesatar i shërbimeve celulare 2011-2013/1**

| | 2011 | 2012 | 2013/1 | Ndryshimi 2013/1 me 2012 |
|---|---|---|---|---|
| **Perdorues Karta SIM** | | | | |
| **Thirrje dalese ne muaj** | 83 | 93 | 107 | 15% |
| **Thirrje te marra (hyrëse) ne muaj** | 94 | 103 | 115 | 12% |
| **MOU*** | **177** | **195** | **222** | **14%** |
| **SMS (dalëse) ne muaj** | 12 | 21 | 26 | 24 % |
| **Perdorues Aktive** | | | | |
| **Thirrje dalese ne muaj** | 130 | 152 | 162 | 7% |
| **Thirrje te marra (hyrëse) ne muaj** | 147 | 168 | 175 | 4% |
| **MOU*** | **277** | **319** | **337** | **6%** |
| **SMS (dalëse) ne muaj** | 19 | 35 | 40 | 14% |

Edhe ne periudhen e 6 mujorit te I-re 2013, vihet re tendenca e rritjes se perdorimit te sherbimeve nga perdoruesit (dy kategorite e specifikuara) te ofruara nga rrjetet celulare.

Ne kolonen e fundit (ndryshimi ndermjet 2013/1 dhe 2012), vihet re nje rritje e secilit nga treguesit e paraqitur ne tabele.

Konsumi i thirrjeve duke krahasuar te dhenat e 6 mujorit te I-re 2013 me te dhenat e fund vitit 2012, rezulton qe eshte rritur mesatarisht me 14%, e matur me perdorues sipas kartave SIM, dhe 6 % e matur sipas perdoruesve aktive.

Ndersa perdorimi i SMS-ve duke krahasuar te dhenat e 6 mujorit te I-re 2013 me te dhenat e fund vitit 2012, rezulton qe eshte rritur mesatarisht me 24%, e matur me perdorues sipas kartave SIM, dhe 14 % e matur sipas perdoruesve aktive.

Gjate 6 mujorit te I-re 2013, nje perdorues celular (vleresuar sipas kartave SIM) ka kryer mesatarisht 107 minuta thirrje dalese dhe ka marre 115 minuta thirrje hyrese, duke rezultuar ne 222 minuta komunikim thirrje telefonike ne muaj dhe ka derguar 26 SMS ne muaj. Nese do i referoheshim konsumit mesatar per nje perdorues aktive, keto vlera jane shume me te medha: ka kryer mesatarisht 162 minuta thirrje dalese dhe ka marre 175 minuta thirrje hyrese, duke rezultuar ne 337 minuta komunikim thirrje telefonike ne muaj dhe ka derguar 40 SMS ne muaj.

AKEP gjykon se minutat reale të përdorimit mesatar janë më afer treguesve te matur me perdorues aktive, pasi një numër i konsiderueshëm pajtimtarësh te kartave SIM janë vetëm përdorues sezonalë apo sporadikë (emigrantë, vizitorët që përdorin karka SIM të operatorëve celularë Shqiptarë gjatë qëndrimit të përkohëshëm apo vizitave në Shqipëri).

**Sherbimi Roaming**

**Tabela 4: Sherbime roaming nderkombetar 2010 – 2013/1**

| | 2010 | 2011 | 2012 | 2013/1 |
|---|---|---|---|---|
| Numri i pajtimtareve te rrjeteve Shqiptare qe kane perdorur Roaming Nderkombetar | 549,703 | 954,586 | 961,188 | 419,673 |
| Numri i pajtimtareve te rrjeteve te huaj qe kane perdorur Roaming Nderkombetar ne Shqiperi | 2,703,290 | 4,243,532 | 5,849,021 | 2,241,425 |

Nga tabela vihet re qe te dy treguesit jane reduktuar ndjeshem. Duhet sqaruar fakti se kjo ka ardhur pasi nga ana e operatoreve eshte bere tjeter matje e ketyre treguesve (ne krahasim me periudhat e meparshme), duke bere matje per numrin e pajtimtareve qe perdorin sherbimin roaming dhe jo numrin e vizitave qe mund te perdor nje pajtimtar (frekuenca e vizitave)...

**Sherbimi mesazheve MMS**

Perdorimi i sherbimeve MMS per 6 mujorin e I-re te vitit 2013/1, duke e llogaritur si nje mesatare mujore rezulton te kete nje rritje duke bere krahasimin e 6 mujorit te I-re 2013 me te dhenat e vitit 2012 dhe konkretisht nga rreth 34 mije MMS ne muaj ne vitin 2012 ka arritur ne rreth 36 mije MMS ne muaj ne 6 mujorin e I-re 2013.

**Sherbime UMTS ( 3G)**

Aktualisht ne treg referuar te dhenave te 6 mujorit te I-re 2013, kemi tre ofrues te sherbimit 3G, si Vodafone Albania, AMC dhe Eagle Mobile. Klasifikimi i perdoruesve qe perdorin sherbimin 3G npermjet aparatit celular dhe perdorues 3G nepermjet kartave modem USB te cilat perdoren per akses ne PC, lap top, te specifikuara jepen ne tabelen e meposhtme:

**Tabela 5: Tregues te ofrimit te sherbimeve 3G (2011- 2013/1)**

| | Viti | AMC | VF | EM | TOTAL |
|---|---|---|---|---|---|
| **Numri pajtimtareve te telefonise mobile me akses ne Internet broadband UMTS ne total:** | **2011** | 55,000 | 228,249 | | 283,249 |
| | **2012** | 240,715 | 408,998 | | 649,713 |
| | **2013/1** | **240,431** | **241,445** | **59,958** | **541,834** |
| | **Ndryshimi ne % (2013/1 me 2012)** | **(-0.12)%** | **(-40)%** | | **(-17)%** |
| **- nepermjet aparatit te telefonit celular** | **2011** | **46,000** | **202,756** | | **248,756** |
| | **2012** | **222,882** | **371,426** | | **594,308** |
| | **2013/1** | **222,460** | **220,396** | **57,076** | **499,932** |
| | **Ndryshimi ne % (2013/1 me 2012)** | **(-0.19)%** | **(-41)%** | | **(-16)%** |
| **- nepermjet cards/modems/keys (jo aparate celulare)** | **2011** | **9,000** | **25,493** | | **34,493** |
| | **2012** | **17,833** | **37,572** | | **55,405** |
| | **2013/1** | **17,971** | **21,049** | **2,882** | **41,902** |
| | **Ndryshimi ne % (2013/1 me 2012)** | **(0.78)%** | **(-41)%** | | **(-16)%** |

Nga tabela vihet re se numri i perdorueve 3G ne te gjithe treguesit ka renie krahasuar me te dhenat e fund vitit 2012. Pavaresisht rritjes se numrit te ofruesve te sherbimit 3G dhe konkurrences ne ofrimin e paketave te sherbimeve, nuk rezulton e njejta gje per rritjen e numrit te perdoruesve te sherbimeve 3G.

## Portabiliteti

Edhe per 6 mujorin e I-re 2013, ne lidhje me te dhenat e evidentuara nga database e portabilitetit, rezulton qe:

Sasia e numrave te celulare te bartur deri ne fund te 6 mujorit te I-re 2013, per rrjetet celulare arriti ne 193,346 (ne total), kundrejt 136,998 (ne total) qe ishte ne fund te vitit 2012, gje qe tregon nje rritje prej rreth 41%, duke reflektuar efektin e kesaj mase rregullatore edhe ne zhvillimin e konkurrences ne tregun cellular.

Koha mesatare qe i duhet nje pajtimtari per te bartur numrin, nga momenti i dergimit te kerkekes deri ne marrjen e sherbimit nga operatori i ri eshte 1.6 dite, ndersa koha mesatare qe abonentet ngelen pa sherbim eshte rreth 75 minuta.

Aplikimi i mases rregullatore per portimin e numrit edhe per rrjetet fikse, rezulton te kete te dhenat per 6 mujorin e I-re 2013 ne shifren totale rreth 944 pajtimtare qe kane perdorur mundesine e portimit te numrit ne rrjetet fikse.

# IV. TELEFONIA FIKSE

## IV.1 Numri i pajtimtareve dhe pjeset e tregut

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në fund të 6 mujorit te pare te vitit 2013, arriti ne rreth 280 mije, krahasuar me rreth 311 mije qe ishte ne fund te vitit 2012. Pas sqarimeve te bera me operatoret perkates, sjellin ne vemendje se ne raportimet e tyre jane konsideruar vetem pajtimtaret aktive (pagues), ndersa numri i pajtimtareve ne totalin e tyre rezulton te jete pothuajse i njejte me raportimet e fund vitit 2012. Kjo përbën një renie me rreth 10 %. Kryesisht kjo renie ka ardhur per shkak te reduktimit te numrit te pajtimtareve te Albtelecom me rreth 11mije krahasuar me te dhenat e fund vitit 2012 si dhe ndryshimit te madh te sjelle ne te dhenat e operatorit alternativ Abcom, pasi referon te dhena me nje renie rreth 20 mije pajtimtare (sipas percaktimit te bere vetem si pajtimtare aktive). Sqarojme qe ne te dhenat e fund vitit 2012 Abcom ka raportuar 33 mije pajtimtare, ndersa ne fund te 6 mujorit te i-re 2013, referon vetem 13 mije pajtimtare.

Duke vleresuar te dhenat e derguara nga operatoret e telefonise fikse, pavaresisht tendences ne ulje e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse qe duket se po ndjek ate te vendeve te BE, ne Shqiperi rezulton qe norma e penetrimit te telefonise fikse ne Shqiperi eshte rreth 10 %, kundrejt penetrimit prej 11% qe ishte ne fund te vitit 2012 dhe ne nje nivel qe është shumë i ulët krahasuar me vendet e BE ( me një mesatare prej 40%) dhe vendet e rajonit.

Figura e meposhteme paraqet ecurine e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse dhe Albtelecom dhe operatoreve alternative.

**Figura 7. Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2000-2013/1**




| | 2000 | 2001 | 2002 | 2003 | 2004 | 2005 | 2006 | 2007 | 2008 | 2009 | 2010 | 2011 | 2012 | 2013/1 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Albtelecom | 152,70 | 197,50 | 213,00 | 228,85 | 236,26 | 248,05 | 259,63 | 261,14 | 263,96 | 292,88 | 277,76 | 258,94 | 244,00 | 218,97 |
| OA | | | 9,000 | 15,000 | 20,000 | 25,000 | 30,000 | 35,000 | 40,000 | 45,000 | 53,739 | 79,901 | 81,000 | 60,463 |
| Fiks | 152,70 | 197,50 | 222,00 | 243,85 | 256,26 | 273,05 | 289,63 | 296,14 | 303,96 | 337,88 | 331,50 | 338,84 | 325,00 | 279,43 |

Vihet re qe ne te dhenat e raportuara ne fund te 6 mujorit te I-re 2013, numri total i pajtimtareve te operatoreve alternative ka pesuar ndryshime te ndjeshme krahasuar me te dhenat e fund vitit 2012. Sqaruam me siper se ndryshimi kryesore ka ardhur si pasoje e rapotimve te bera nga Abcom, i cili ne matjet e bera ne rrjetin e tij ka konsideruar vetem pajtimtaret (perdorues pagues) dhe jo numrin e plote te pajtimtareve te lidhur ne rrjetin e tij, per te cilin deklaron se eshte i njejte me te dhenat e fund vitit 2012.

**Tabela 6: Ecuria e numrit te pajtimtareve te telefonise fikse sipas operatoreve (2010-2013/1)**

| | Albtelecom | Abcom | ASC | Nisatel | Primo | AMC Fiks | OA te tjere | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **2013/1** | 218,975 | 13,120 | 9,896 | 6,913 | **1,661** | **6,339** | 22,579 | 279,438 |
| **2012** | 230,397 | 33,000 | 7,649 | 5,500 | **2,584** | **6,119** | 26,412 | 311,661 |
| **2011** | 258,943 | 27,167 | 10,129 | 4,950 | 3,300 | 7,565 | 26,790 | 338,844 |
| **2010** | 277,763 | 19,975 | 7,408 | 5,900 | 3,678 | - | 16,778 | 331,502 |
| Ndryshimi 2013(1)/2012 | -5% | -60% | 29% | 26% | -36% | 4% | -6% | -10% |

**Figura 8: Pjeset e tregut te numrit të pajtimtarëve të telefonise fikse (2013/1)**



# V. INTERNETI

## V.1. Numri i pajtimtareve me akses broadband ne Internet dhe struktura e tyre

Numri pajtimtareve me akses broadband fiks dhe celular (3G me karta USB/modem) ne fund te 6 mujorit te I-re eshte rreth 210 mije, kundrejt rreth 215 mije qe ishte ne fund te vitit 2012, gje e cila perben nje renie prej rreth 3% .

Numri i pajtimtareve me akses broadband me rrjete fikse ne fund te gjashtemujorit te pare 2013 arriti ne rreth 168 mije, qe perben nje rritje me 5% ne krahasim me fund vitin 2012 dhe 20% ne krahasim me fund vitin 2011. Rritja per Albtelecom ka qene e vogel ne rreth 2%, dhe zoteron 41% te tregut broadband fiks me pakice. Nder operatorët alternativë fiks ABCom vazhdon të jete operatori me numrin më të madh të lidhjeve broadband me rreth 42 mije ne fund te 6 mujorit te I-re 2013 (25% pjese tregu), me nje rritje prej rreth 17 % krahasuar me fund vitin 2012. Nje rritje ne nivelin 7%, ka pasur edhe Abissnet, krahasuar me te dhenat e fund vitit 2012.

Numri i pajtimtareve me akses broadband celular (3G me karta USB/modem per perdorim me kompjuter) ne fund te 6 mujorit te I-re 2013 eshte rreth 42 mije, kundrejt 55 mije ne fund te 2012, qe perben nje renie me 31%. Renie te theksuar ne kete trgues ka operatori Vodafone me nje vlere rreth 44%.

**Tabela 7: Shperndarja e numrit te pajtimtareve me akses broadband (2010-2013/1)**

| | Albtelecom | Abcom | Abissnet | ASC | OA te tjere | Total Fiks | AMC | Vodafone | EM | Total Fiks +3G |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2010 | 70,597 | 13,575 | 7,000 | 5,666 | 23,162 | 120,000 | | | | 120,000 |
| 2011 | 60,055 | 29,321 | 15,321 | 10,129 | 24,871 | 139,697 | 9,000 | 25,493 | | 174,190 |
| 2012 | 66,757 | 35,870 | 17,719 | 11,777 | 27,965 | 160,088 | 17,833 | 37,572 | | 215,493 |
| **2013/1** | 67,855 | 41,980 | 18,982 | 10,309 | 28,642 | 167,768 | 17,971 | 21,049 | 2,882 | 209,670 |
| Ndryshimi 2013(1)/2012 | **2%** | **17%** | **7%** | **-12%** | **2%** | **5%** | **1%** | **-44%** | | **-3%** |

Vihet re qe aksesin ne broadband fiks per 2013/1 te kete nje rritje prej rreth 5 %, krahasuar me fund vitin 2012, ndersa ne aksesin ne broadband internet ne Fiks + Celular 3G (karta modem), rezulton te kete nje renie prej rreth 3%. Kjo renie vjen kryesisht nga renia e reflektuar tek Vodafone Albania.

**Figura 9: Pjeset e tregut per akses broadband (2013/1)**






## V.2. Ofrimi me shumicë i aksesit në Internet dhe infrastruktura

Edhe ne 6 mujorin e I-re 2013, krahasuar me te dhenat e fund vitit 2012, nuk vihet re ndonje ndryshim ne lidhje me infrsatrukturen e ndertuar nga opeartoret me qelllim ofrimin e aksesit ne broadband internet dhe rezulton te jete e njejte me te dhenat e fund vitit 2012.
Keshtu qe ne tabelen ne mëposhtme paraqiten disa të dhëna ne lidhje me infrastrukturën e ndërtuar nga operatorët per rrjete me fibr optike dhe lidhjen me Internetin global (lidhje me boten). Nga të dhënat vihet re se konektiviteti me Internetin Global vazhdon te jete ne rreth 30 Gbps. Nderkohe gjatesia e fibres optike e instaluar nga operatoret eshte rreth 4800 km.

**Tabela 8. Te dhena per infrastrukturen e aksesit në Internet në nivel me shumicë 2013/1**

| | Alternative | Albtelecom | Total |
|---|---|---|---|
| **Konektiveti me Internetin Global –Lidhje nderkombetare (Gbps)** | 10 | 20 | 30 |
| **Fibër Optike e instaluar (gjatesia km)** | 1,914 | 2,837 | 4,751 |